



FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT

Adresa: Rr. "Liman Kabe", Nd 5
Myrja 1, Njësia Administrative 5
Kodi Postar 1019, Tirana, Albania

Telefon: +35542 346 601
Fax: +35542 346 609
E-mail: info@fshf.al

VENDIME, UDHEZIME, SHKRESA, KERMESA
VR. 686 DATE 14.01.2021
TERGUAR NGA:
ENDA:



Nr. 53 Prot.

SHKRESA E TITULLARIT

Tiranë, me 11.01.2021

Drejtuar: **Bashkisë Shkodër**
Znj.Voltana Ademi, Kryetare

Lënda: **Kthim përgjigje**

E nderuar znj. Ademi

Në vijim të shkresës tuaj Nr. 101 Prot datë 06.01.2020 përmes te cilës kërkonti bashkëpunimin e Federatës Shqiptare të Futbollit lidhur me procesin e shitjes se aksioneve te klubit anëtar KF Vllaznia, FSHF, duke ju përgëzuar për transparencën dhe gjithë përfshirjen, konfirmon paraprakisht gatishmërinë për t'ju asistuar në këtë proces.

Së pari, lidhur me kriteret e vendosura me vendimet e Këshillit Bashkiak nga pikëpamja formale FSHF nuk ka vërejtje dhe se ne *prima facie* janë në përputhje me ligjin. Nga pikëpamja e detyrimeve statutore të FSHF por edhe në përputhje me Rregulloren e Licencimit të Klubeve për pjesëmarrje në aktivitetet e UEFA-s, te paktën kushtet e mëposhtme duhet të plotësohen:

1. *Subjekti duhet të garantojë që mund të marrë vendime në mënyrë të pavarur nga ndonjë subjekt i jashtëm dhe të sigurojë që çështjet e tij të mos ndikohen në mënyrë të papërshtatshme nga ndonjë palë e tretë, në veçanti që ai është i pavarur nga çdo ndërhyrje apo ndikim politik i papërshtatshëm*
2. *Subjekti të mos jetë dënuar për një krim të rëndë, përfshirë veprën penale të parashikuar nga Neni 197/a i Kodit Penal ose të jetë rehabilituar sipas legjislacionit penal në Republikën e Shqipërisë si dhe të mos jetë i dënuar për trukim ndeshjesh nga organet e FIFA, UEFA ose FSHF;*

Se dyti, lidhur me komisionin e vlerësimit, FSHF propozon që pjesë e tij të jenë përfaqësuesit z. Aldi Topciu, Drejtor i Departamentit Ligjor i FSHF dhe z.Kristaq Ndini me detyrë ekspert i kriterit financiar pranë sektorit te Licensimit.

Mbetemi në dispozicion për veprimet e mëtejshme.

Me konsideratë

Armand DUKA
President



Sponsor Tekstil



Premium Sponsor

